

Mr. Sulltane Koçini — Ukaj

ARSIMI DHE SHKOLLAT NË KOSOVË NDERMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Arsimi ndërmjet dy luftërave botërore nuk mund të shqyrtohet i izoluar prej sistemit të atëhershëm ekonomik-shoqëror dhe prej marrëdhënieve shoqërore në vend. Përkundrazi, është pjesë përbërëse e atij sistemi, sepse ai e diktoi dhe drejtoi udhëheqjen e politikës arsimore në tërë vendin, pra edhe në Kosovë. Kjo do të thotë se politika arsimore në atë kohë ishte ngushtësisht në lidhje me politikën e shtypjes kombëtare dhe të eksploatimit ekonomik të shtresave të gjera popullore nga ana e borgjezisë në pushtet. Në të vërtetë, regjimi i atëhershëm u shpreh në mënyrë deklarative për arsimin e masave të gjera popullore, por, në praktikë, ishte krejtësisht ndryshe.¹

Borgjezia serbe ndoqi kursin e pengimit të arsimit për kombësitë, sidomos për kombësinë shqiptare, për ta mbajtur atë në errësirën e padijes, në mënyrë që ta shtypte dhe ta shfrytëzonte më lehtë. Kjo u kushtëzua nga qëndrimi reaksionar dhe pasiv i klasës në pushtet, që i jepte tonin kryesore politikës së shtetit, dhe nga marrëdhëniet e prapambetura ekonomik-shoqërore.

Vlen të theksohet se secili pushtues, për t'i arritur qëllimet dhe aspiratat e veta, përdoret metoda demagogjike që t'i përvehtësonte masat e gjera popullore. Derisa borgjezia serbe angazhohej me tërë forcat e veta për pengimin e arsimimit të shqiptarëve dhe të kombësive të tjera, pushtuesi austriak, për ta përvehtësuar elementin shqiptar, lejoi zhvillimin kulturor-arsimor dhe hapjen e shkollave në gjuhën amtare. Ato punuan prej vitit 1916 e deri në vitin 1918 në disa vende të Krahinës, si në Gjakovë, Prizren, Pejë, Istog, Mitrovicë, Vuçiternë, etj. Kjo ishte para së gjithash rezultat i aspiratave politike të Monarkisë Habsburgose, por njëherazi edhe kërkesë dhe dëshirë e popullit shqiptar për t'u shkolluar në gjuhën e vet.²

Mirëpo, pas ripushtimit të këtyre viseve nga Mbretëria e SKS, përpjekjet praktike të veprimtarisë arsimore në gjuhën shqipe, jo vetëm që nuk u vazhduan, por, përkundrazi, u ndaluan dhe u luf-

¹ J. Đilas, *Razvoj školstva u Prištini i njenoj okolini izmedju prvog i drugog svetskog rata*, Obeležija, nr. 3, 1972, f. 124.

² Jašar Redžepagić, *Školstvo i prosveta na Kosovu od kraja XVIII stoljeća do 1918. godine*, Priština, 1979, f. 351.

tuan me mjete të ndryshme nga organet arsimore, nga pushteti policor dhe nga mbarë aparati shtetëror. Mbyllja e tyre u bë me motivim më absurd që mund të përshkruhet: me faktin se gjoja vetë shqiptarët nuk dëshironin t'i ndiqnin mësimet në to."

Në vend të tyre u hapen shkolla, ku mësimi zhvillohej ekskluzivisht në gjuhën serbe, gjë që ishte në frymën e politikës së borgjezisë serbomadhe dhe që u sanksionua në Ligjin e shkollave popullore.⁴

Menjëherë pas Luftës së Parë Botërore filloi ripërtëritja e shkollimit fillor dhe e atij të mesëm. Mirëpo, situata e pavolitshme politike dhe shoqërore dhe pasojat e luftës nuk lejuan që rrjeti i shkollave fillore të zgjerohej deri në vitin 1925. Asokohe në Kosovë kishte shumë pak shkolla fillore dhe ato hapeshin kryesisht në fshatra e vendbanime, ku shumicën e popullsisë e përbënin serbët dhe malazeztë, ndërsa në vendbanimet e banuara me shumicë nga popullsia shqiptare ato ishin të rralla ose nuk ekzistonin fare.⁵

Numri i shkollave fillore shtohej shumë ngadalë. Nga viti 1925 fillon periudha e hapjes së shkollave fillore dhe ajo vazhdon deri më 1939, ndërsa këtu e deri në kapitullimin e Jugosllavisë së Vjetër, më 1941, shkollat hapen fare pak.⁶

Shkollimi fillor në Jugosllavinë e Vjetër ishte formalisht i detyrueshëm, sepse jo vetëm që nuk zbatohej ai, por as që bëheshin përpjekje për këtë. Në Maqedoni dhe në Kosovë në vitin shkollor 1927—28 kishte 7565 nxënës kryesisht të kombësisë shqiptare që vijonin shkollën fillore.⁷

Për nxënësit shqiptarë mësimi zgjaste pesë vjet, ngase një vit detyroheshin t'i ndiqnin mësimet në klasën gatimore, pasi që nuk e njihnin serbishten. Në këto klasa gatimore, përveç gjuhës serbishte, mësoheshin edhe matematika dhe një lëndë fetare. Nga klasat gatimore kalonin në klasat e para vetëm 20—40 për qind të nxënësve të regjistruar. Kjo bënte që nxënësit shqiptarë të shkapërdheshin që në klasën e parë. Shkapërdërdhja vijonte edhe në klasën e dytë dhe të tretë, kështu që në klasën e katërt ishin të rrallë emrat shqiptarë.⁸

Për këtë shkak, si dhe për shkak të trajtimit jonjerëzor nga shumica e mësuesve, nxënësit shqiptarë nuk shkonin me dëshirë në shkollë. Nga ana tjetër, edhe vetë organet shkollore mundësonin mosvijimin e nxënësve, meqë pushtetmbajtësve u konvenonte një gjendje e këtillë, ku pjesa dërmuese e popullsisë, veçanërisht ajo shqiptare, mbetej analfabete.

Nga të dhënat statistikore për vitin 1939—40 shihet se në Kosovë kishte 252 shkolla të detyrueshme me 37.885 nxënës dhe 657

³ Si shënimi 2.

⁴ Muhamet Shatri, *Prizreni dhe rrethina në Lëvizjen Nacionalçlirimtare 1941—1945*, (Tezë e doktoranturës), f. 31.

⁵ Si shënimi 1, f. 124, 125.

⁶ *Po aty*.

⁷ M. Kodra, *Albanska narodnost Makedonije u NOP-u*, (Tezë e doktoranturës), f. 22.

⁸ Arkivi i Kosovës, *Regjistrat e nxënësve për vitet 1927—41*.

mësimdhënës. Në vitin shkollor 1940—1941 në shkollat fillore ishin 20.914 serbë e malazez dhe vetëm 11.876 shqiptarë.⁹

Shumë pak investohej edhe në ngritjen e ndërtesave shkollore. Lokalet mësimore të trashëguara nga periudha e mëparshme ishin shumë të këqija dhe, në pjesën më të madhe, të papërdorshme. Në shumicën e rasteve mësimi zhvillohej në shtëpi private, të vjetra, pa hapësirë dhe pa kushte të nevojshme higjienike. Në gjendje të vështirë ishin sidomos shkollat e fshatrave, disa nga të cilat u meremetuan apo u ndërtuan vetëm në vitin 1940. Kjo e vështirësoi zhvillimin e rrjetit të shkollave fillore dhe të atyre të mesme.¹⁰ Një gjendje të këtillë të rrjetit shkollor në Kosovë e kemi kur 84 për qind e popullsisë së kësaj treve ishte analfabete, e kjo është përqindja më e madhe kundrejt pjesëve të tjera të vendit.¹¹

Mungesën e arsimit në shkollat fillore shtetërore masat e gjera të besimit islam, shqiptarët dhe turqit, e zëvendësuan me shkollat fetare për fëmijë, sebian mektebet që ishin primitive dhe të paafërshme për botëkuptimet fëmijërore. Kështu, për popullsinë shqiptare dhe turke u hapen shkolla fetare private — mejtepe e medrese, të cilat ishin mjaft të papërshtatshme dhe nuk i plotësonin nevojat më elementare edukativo-arsimore të kohës. Shkolla të tilla ishin të vendosura në shtëpi private dhe pranë xhamive. Derisa nëpër qytete mejtepet ishin pak më të rregulluara dhe mësimi zhvillohej çdo ditë, nëpër fshatra gjendja ishte shumë më e keqe dhe mësimi nuk zhvillohej në mënyrë të rregullt. Gati çdo ish-at ca më i madh kishte mejtep. Ligjëratat mbareshin gojarisht, pa libra e programe. Mësimi në këto shkolla zgjaste tri vjet dhe vijohej nga fëmijë të moshës jomadhore. Edhe pse nxënësit mësonin alfabetin arab dhe në gjuhën shqipe fitonin bazat themelore të edukatës islame, ato u bënë bartëse të vetme të arsimit të pjesës më të madhe të popullsisë së kësaj ane.¹²

Megjithë nivelin e ulët dhe format jopërkatese të punës, organet e pushtetit bënë shpesh kërkesat që të mbylleshin dhe të ndaloheshin mejtepet dhe medrestë, që fëmijët shqiptarë të mos përfshiheshin si në shkollat serbe. Tëtohej që rinia shqiptare të lihej anash çdo veprimtarie kulturore-arsimore, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të zbatohej politika e gjykimit të shqiptarëve për katastrofë kulturore-arsimore.¹³

⁹ Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Kosovës, *Neki podaci o razvoju svih vrsta škola pre rata, za vreme rata i posle oslobodjenja, period 1940—51*, Povereništvo za prosvetu i kulturu, Priština.

¹⁰ Si shënimi 4, f. 32.

¹¹ Këshilli Popullor i Krahinës Autonome të Kosovës-Metohisë 1943—1953, *Prishtinë 1955*, f. 31.

¹² Dr. Izber Hoti, *Jeta kulturore dhe arsimore në Prishtinë dhe në rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore*, *Horizontet e historisë*, nr. 5/6, Prishtinë, 1981/1982, f. 100.

¹³ M. Pirraku, *Kulturno-presvetni pokret albanaca u Jugoslaviji (1919—1941)*, *Jugoslovenski istorijski časopis*, nr. 1—4, 1978, f. 359—360.

Arsimi me karakter fetar më të plotë e më të thellë fitohej nëpër mederse, të cilat punonin që nga koha e Perandorisë Osmane. Këtu mësimi zhvillohej sipas lëndëve dhe, pas kryerjes, mërrëshin tituj fetarë (imam) dhe mund të vijoheshin mësimet në Medresenë e Lartë të Shkupit, ngase kjo kishte rangun e medresesë së mesme. Mirëpo, në këtë medrese mësonin shumica e fëmijëve të prindërve të pasur dhe me numër të caktuar, ngase të varfërit nuk kishin mundësi të regjistroheshin në te.¹⁴ Një numër i këtyre nxënësve braktisën shkollat turke të Shkupit dhe vazhduan mësimin në Normalen e Elbasanit.¹⁵

Medresja e Madhe e Shkupit u formua me dekret të mbretit Aleksandri i Parë, më 28. 04. 1924, dhe në të, përveç lëndëve fetare, në (programin mësimor ishin të gjitha lëndët shkencore dhe profesionale që mësoheshin në shkollat e mesme shtetërore. Mu për këtë arsye programit të saj shkencor), në këtë medrese depërtuan idetë përparimtare socialiste ndër nxënësit shqiptarë dhe myslimanë dhe shumica sish u inkuadruan në Lëvizjen Nacionalçlirimtare dhe ranë dëshmorë për çlirimin e atdheut tonë nga okupatori fashist.¹⁶

Forma tjetër ku shqiptarët e shprehin disponimin e tyre shpirtëror ishte tradita, e cila që herët kishte zënë rrenje te këta anasë. Nëpërmjet këngës e vallës, përrallave e tregimeve, kashelashave dhe fjalëve të urta popullore, folklorit riteve dhe veçorive të tjera etnografike, shqiptarët brez pas brezi e gojë më gojë paraqesin disponimin e tyre shpirtëror. Me një simbolikë të mprehtë, shqiptari kudo shprehu gjendjen e vet, vuajtjet, luftën, guximin, trimërinë, dashurinë dhe vyrtetet më të larta të tij. Kështu, oda, ahengu, vdekja dhe ndeja të tjera u bënë „institucione” të arsimit dhe kulturës ku zhvilloheshin biseda edukative-didaktike.¹⁷

Si shkolla të vetme laike në këtë kohë numëroheshin gjimnazet. Ato filluan punën që nga vitet 1913—1914.¹⁸ Këso gjimnazesh vepronin në Prishtinë, Pejë e Prizren. Në Prishtinë gjimnazi ia filloi punës së vet që nga viti 1913. Po në këtë vit u hapën dy paralele mësimi me 123 nxënës, prej të cilëve 23 ishin femra. Në vitin shkollor 1914—1915 gjimnazi e filloi punën me një paralele të klasës së parë dhe dy paralele të klasës së dytë. Mirëpo, për shkak të Luftës së parë Botërore, që në tetor të vitit 1915 kjo shkollë ndërpreu punën.¹⁹

Në Prizren qysh në vitin 1907 ekzistonte Shkolla Tregtare, e cila trajtohej si gjimnaz katërklasësh. Mirëpo, me kërkesë të opinionit të qytetit, gjashtë vjet më vonë, më 14 janar 1913, themelohet gjimnazi me dy paralele dhe 73 nxënës.

¹⁴ Si shën. 13, 104.

¹⁵ Iljaz Gogaj. *Mbi qëndrimin reaksionar të klerit në fushën e arsimit*, Tiranë 1972, 36.

¹⁶ Mr. Iljaz Rexha, *Poema revolucionare e Haxhi Ymer Lutfi Paçarizit*, Vjetar 1981, f. 223.

¹⁷ *Dymbdhjetvet zhvillimi kulturor të Kosovës e Metohisë*, Prishtinë, 1957; Si shën. 39.

¹⁸ Dr. Svetozar Čanović, *Specifični problemi nastave u školama Kosova i Metohije*, Priština, 1967, f. 18.

¹⁹ Si shën. 1. f. 138.

Në vitin shkollor 1914—1915 hapet edhe klasa e dytë me një paralele dhe 45 nxënës. Me fillimin e Luftës së Parë Botërore, gjimnazi ndërpreu punën dhe kjo shkollë u shndërrua në kazermë ushtarake, spital, depo, etj. Pas mbarimit të luftës, puna në këtë gjimnaz nuk filloi menjëherë, sepse ndërtesa e tij ishte tejet e dëmtuar. Ministria e Arsimit dha hua për meremetimin e kësaj ndërtese dhe më 5 mars 1919 filloi mësimi i rregullt me 200 nxënës të regjistruar. Në fillim zhvillimi i mësimit ishte vështirësuar, mungonte kuadri mësimor. Për mësimdhënës shfrytëzcheshin mësues, priftërinj, studentë të padiplomuar, tagrambledhës dhe rusë emigrantë. Dalëngadalë gjendja filloi të përmirësohej. Në vitin shkollor 1920—1921 numri i nxënësve dyfishohet në 400. Po në këtë vit, më 4 gusht, gjimnazi fiton edhe klasën e pestë, ndërsa me 16 maj 1922 gjimnazi bëhet gjashtëklasësh. Një vit më vonë, më 1923—1924 hapet edhe klasa e shtatë, ndërsa më 27 shtator 1924 gjimnazi bëhet edhe me klasën e tetë dhe shndërrohet në gjimnaz të plotë.²⁰

Rëndësia e Gjimnazit të Prizrenit u rrit edhe më tepër pas vitit 1929, kur u ngushtua rrjeti i shkollave të mesme dhe kur u mbyllën gjimnazet në Gjakovë, Gjilan, Ferizaj dhe kur Gjimnazi i Pejës u shndërrua në gjimnaz jo të plotë. Në këtë mënyrë, përveç Gjimnazit të Prishtinës, Gjimnazi i Prizrenit mbeti qendra e vetme e arsimit të mesëm në Kosovë. Gjatë vitit 1939—1940 në këtë gjimnaz mësonin 622 nxënës prej të cilëve meshkuj 479 dhe femra 151. Në të jepnin mësim 28 arsimtarë dhe profesorë. Deri në Luftën e Prillit në këtë gjimnaz u diplomuan 460 nxënës, kryesisht serbë dhe malazet.²¹

Përveç Gjimnazit në Prizren ekzistonte edhe Shkolla Teologjike, e hapur në vitin 1871. Për mirëmbajtjen e saj qe angazhuar mjaft edhe konsulli rus Jastrebov. Deri në vitin 1922 kjo shkollë funksionoi si shkollë gjysma fetare-gjysma laike, kur edhe u suprimua seksioni i normales. Në vitin shkollor 1939—1940 kjo shkollë kishte 109 nxënës dhe 14 arsimtarë e profesorë. Pranë kësaj shkolle vepronte edhe biblioteka me një fond mjaft të pasur librash.²²

Në vitin shkollor 1919—1920 hapen edhe gjimnazet e ulëta në Gjilan, Ferizaj dhe Mitrovicë.²³

Në këtë periudhë, në Mitrovicë, pos Gjimnazit të Ulët Real, nuk kishte shkolla të mesme. Pas mbarimit të klasës së katërt, nxënësit vazhdonin shkollimin në Gjimnazin e Prishtinës, të Pejës ose të Prizrenit.

Me vendimin e Ministrisë së Arsimit më 24. 06. 1932, ky gjimnaz u suprimua. Suprimimi i tij justifikohej me mendimin që të mos krijohej, „një proletariat i tepërt intelektual"! Mirëpo, nën presionin e opinionit të qytetit dhe të rrethinës, me dekret të ministrit të Arsimit (8 gusht 1932), shkolla u rihap, por tash si gjim-

²⁰ *Državna realna Gimnazija u Prizrenu*, Izveštaj za školsku 1937—1938. godinu, Skoplje, 1938, f. 4, 5, 6, 7.

²¹ Si shën. 4. f. 24.

²² *Po a'j*, si shënimi 20.

²³ Si shën. 18. f. 82.

naz vetëqeverimi që do të thoshte se për ekzistimin e tij prindërit detyroheshin të paguanin shuma bukur të mëdha. Një vit më vonë, më 1933, shkolla u shndërrua në Gjimnaz Real Shtetëror. Deri në vitin 1941 kjo shkollë mbeti katërklasëshe.²⁴

Në vitin 1920—1921 Gjimnazi i Prishtinës u shndërrua në gjimnaz të plotë. Përveç mësimit të rregullt, këtu organizoheshin edhe kurse shkollore. Kurset i vijoin gjeneratat e Gjimnazit të paraluftës. Kurse të tilla u organizuan deri në vitin 1923, kur u normalizua mësimi i rregullt. Në këto kurse nxënësit kryenin brenda një viti nga dy klasa. Gjatë vitit 1920—1921 u diplomuan 31 veta. Në vitin e njëjtë Gjimnazi u rrit në gjimnaz të plotë — gjimnaz tetëklasësh.²⁵

Në Gjimnazin e Prishtinës gjatë një viti kishte mesatarisht 600—700 nxënës. Numri i nxënësve shqiptarë në këtë Gjimnaz ishte shumë i vogël. Gjatë vitit shkollor 1936—1937 në të gjitha klasat kishte vetëm 15 nxënës të kombësisë shqiptare, ndërsa në vitin shkollor 1939—1940 në këtë gjimnaz ishin 13 nxënës shqiptarë. Gjatë ekzistimit të këtij gjimnazi u diplomuan vetëm 20 maturantë shqiptarë, të cilët ishin kryesisht fëmijë pasanikësh.²⁶

Në vitet 1921—1922 Gjimnazi i Pejës u shndërrua në gjimnaz të plotë dhe punoi gjer në vitin 1929, kur edhe mori statusin gjimnaz jo i plotë vetëqeverimi.²⁷ Më 1932—1933 ky gjimnaz u shndërrua përsëri Gjimnaz i Lartë Vetëqeverimi ndërsa më 1935—1936 u bë Gjimnaz Shtetëror. Në vitin 1938—1939 ky Gjimnaz kishte nga tri paralele të klasës së parë, të klasës së dytë, të klasës së tretë, dhe të klasës së katërt, nga dy të klasës së pestë, të klasës së gjashtë dhe dy të klasës së shtatë, ndërsa për klasat e teta nuk kemi të dhëna se sa paralele pati ky gjimnaz. Numri i nxënësve të regjistruar ishte 684.²⁸

Gjimnazi Shtetëror i Pejës punoi gjer në vitin 1941. Në kuadër të tij vepronte edhe kuzhina shkollore për nxënës të varfër. Në këtë shkollë nuk ekzistonte biblioteka, por vetëm një librari e nxënësve.

Vlen të theksojmë se ky Gjimnaz në prag të Luftës së Dytë Botërore punonte me kuadër të plotë mësimit, nga radhët e sllovenëve, kroatëve, serbëve dhe malazezve, një numër emigrantësh rusë dhe një bullgar.²⁹

Të dhenat statistikore dëshmojnë se edhe në shkollat e mesme (gjimnazet, progjimnazet), ka pasur një numër relativisht të vogël nxënësish. Në vitin 1939—1940 kishte gjithsej 5221 nxënës, kryesisht serbë e malazez, në Gjimnazin e Pejës, të Prishtinës dhe të Prizrenit. Numri i shqiptarëve në këto gjimnaze ishte shumë i vogël. Në këtë periudhë, nga numri i përgjithshëm i të regjistruarve, shqiptarë ishin vetëm 2 për qind. Është e njohur se në fund të

²⁴ Dr. Jašar Redžepagić, *Rrethanat arsimore dhe shkollat*, „Mitrovica dhe rrethina”, Mitrovicë, 1979, f. 178.

²⁵ *Spomenica 25-godišnjice oslobođenja južne Srbije*, Skopje, 1937, f. 1016—1017.

²⁶ Si shënimi 13, f. 105.

²⁷ Si shënimi 19, f. 81.

²⁸ Arkivi i Kosovës, *Amza e nxënësve për vitin 1938—1939*. Sig. 1, 2, 3, 4.

²⁹ Raport i nxjerrë nga gjimnazi „11 Maji” i Pejës.

vitet 1939—1940 kishte 1126 punëtorë të arsimit — 728 mësues, 273 profesorë, mësime dhënë dhe mësues të cilët punonin në shkolla të mesme, dhe 125 arsimtarë dhe mësues, të cilët punonin në shkolla të ulëta profesionale.³⁰

Vetë fakti se në këto shkolla regjistroheshin fëmijët e pasanikëve, tregon se nuk siguronin kushte për shkollimin e masave të gjera popullore. Nxënëse shqiptarë nuk u njihje përkatësia kombëtare dhe ata trajtoheshin si turq të Jugosllavisë.³¹ Edhe këtu pasqyrohej politika e padrejtë e pushtetit të Jugosllavisë së Vjetër.

Ligji i shkollave qytetare që u nxor në vitin 1931, e ndau këtë shkollë nga shkollat popullore dhe e trajtoi si shkollë jo të plotë të mesme me arsimin për „jetë praktike“.³²

Kështu, për nevojat e ekonomisë u hapën shkolla të ulëta profesionale, në fakt shkolla zejtare të çirakëve, të cilat nuk ishin në rangun e shkollave të mesme. Këto u hapën nëpër disa qendra të Kosovës, si në Pejë, Prizren, Prishtinë, Gjiilan, Mitrovicë, Ferizaj dhe Gjakovë.³³

Në këto shkolla mësoheshin gjuha serbokroate, gjeografia, arti figurativ, fizika, kimia, gjeometria, koniabiliteti dhe higjiena. Mësimin e mbanin mësues të rëndomtë, të cilët ishin me vende të përhershme të punës në shkollat fillore kurse nuk kishin kurrfarë njohurish për këto shkolla profesionale. Mësimi zhvillohej pa kurrfarë mjetesh konkretizimi dhe, siç shihet nga vetë fondet e lëndëve, ishte lënë pas dore plotësisht ngritja profesionale e çirakëve. Mësimi mbahej dy deri tri herë në javë në lokalet e shkollave fillore, në mbrëmje, pas orarit të punës, atëherë kur fëmijët ishin të lodhur e të rraskapitur nga puna e mundimshme e ditës. Frandaj, ata nuk ishin në gjendje të kuptonin asgjë nga ligjëratat stereotipe të mësuesve, ndaj efekti i tyre ishte shumë i vogël.³⁴

Më 1919 në Prishtinë u hap shkolla Zejtare-Tregtare. Gjatë ekzistimit dhe punës kjo shkollë ndërroi emrin disa herë. Në fillim quhej Shkolla Zejtare-Tregtare, më vonë Shkolla Tregtare-Zejtare, ndërsa që nga viti 1935 ajo quhej Shkolla Profesionale e Vazhduar.³⁵ Përveç kësaj shkolle në Prishtinë ekzistonte edhe Shkolla e Qilimave dhe Shkolla e Çirakëve.³⁶

Në Prizren ekzistonin Shkolla pesëklasëshe Zejtare e Femrave, Shkolla trivjeçare Zejtare e Mbrëmjes, ose si e quanin ndryshe Shkolla Vazhduese — Vijuese Profesionale, Shkolla e Femrave, Shkolla e Shoqatës Mirëbërëse „Sërpkinja“.³⁷

³⁰ Ali Hadri, *Kosovo i Metohija u Kraljevini Jugoslavije*, „Isotrijski Glasnik“, 1—2, 1967, f. 81.

³¹ Arkivi i Kosovës, *Upisnica prvog razreda za 1924—1925*, LXXXV, III, Inv. 1, 2.

³² Si shën. 18, f. 82.

³³ R. Abdyli, *Gjendja dhe pozita e çirakëve në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore*, „Rilindja“ 19. 10. 1983, f. 15.

³⁴ Si shën. 33, f. 15.

³⁵ AK, *Skola učenika u privredi*, Inv. 2. Priština, Prishtinë, 1959, 23.

³⁶ AK, „Zenska Zanatska Škola“. LXXXVI Inv. 3.

³⁷ Jašar Redžepagić, *Razvoj prosvete i školstva albanske narodnosti na teritoriji današnje Jugoslavije do 1918*, Priština, 1968, 80—81.

Në Gjilan ekzistonte Shkolla Zejtare e Femrave. Ajo filloi punën në vitin 1920 dhe veproi gjer në vitin 1941. Ndryshe nga viset e tjera të Kosovës, në Gjilan shkollën e këtillë e ndoqen më së shumti femrat shqiptare. Sipas të dhënave prej vitit 1920, kur u formua kjo shkollë, e deri më 1941, kanë ndjekur atë 15 femra shqiptare.³⁸ Kuptohet, ky numër është i vogël në krahasim me ato të kombësisë serbe në këtë periudhë.

Puna praktike në këtë shkollë kryhej në të gjitha klasat bashkërisht, sepse numri i nxënësve nëpër klasa ishte i vogël. Zakonisht mësohej qëndisja, thurja, qepja, mirëmbajtja e rrobave dhe e gjësendeve shtëpiake.³⁹

Në Gjakovë, Shkolla Zejtare e Femrave fillon punën në vitin 1925, por, pas dy vjetëve mbyllet për shkak të numrit të vogël të nxënësve.⁴⁰

Ndër shkollat profesionale në Mitrovicë (Mitrovicën e Titos), ishte Shkolla Zejtare e Femrave për edukimin profesional të tyre. Në këtë shkollë bëhet edukimi dhe specializimi i rinisë femërore, që duhej të përgatitej për format e ndryshme të punës së grave dhe për përparimin e artizanatit shtëpiak. Zakonisht në këtë shkollë, që zgjaste tri vjet, regjistroheshin nxënës të varfëra.⁴¹

Në krahasim me arsimin e përgjithshëm popullor, arsimit profesional gëzonte një trajtim të veçantë. Kjo, zatën, ishte edhe nevojë e kohës. Zhvillimi i mëtejshëm i zejtarisë, tregtisë, xehetarisë dhe i degëve të tjera ekonomike kërkonte edhe njerëz të aftë profesionalë. Kjo i ndihmonte klasës sunduese që të nxirrte sa më shumë fitime, prandaj edhe nuk ngurronte të hapte shkolla profesionale. Shkolla të tilla në Kosovë ekzistonin gjer në vitin 1948, kur edhe u mbyllën.

Ndër forma më të preferuara për përhapjen e arsimit dhe të kulturës ishin edhe universitetet popullore. Universiteti i parë popullor në Krahinë u hap në Prishtinë në vitin 1933. Në këto universitete mbaheshin ligjërata të ndryshme për të rritur.⁴²

Formë tjetër e përhapjes së arsimit e të kulturës ishte edhe hapja e bibliotekave dhe e sallave të leximit. Këto hapen veçanërisht pas viteve 1935—1936 me përkrahjen e forcave përparimtare të PKJ-së dhe të LRKJ-së.⁴³

Këso bibliotekash hasim pranë gjimnazeve, xhamive e kishave. Kështu, p.sh. në Prizren kishte dy biblioteka në xhami, kryesisht me libra në gjuhën arabe, turke dhe persiane.⁴⁴ Në bibliotekën e kishës katolike kishte libra dhe revista në gjuhën shqipe,

³⁸ AK, *Zenske zanatske škole*, Dok. raport.

³⁹ AK, LXXXVL, *Zenska Zanatska škola Gnjilane*, Inventari, 1, 4, 5, 6, 7, 8.

⁴⁰ Drita Gunga, *Lëvizja e grave në Kosovë mes dy luftërave botërore* (punim magjistrature f. 35).

⁴¹ Jashar Rexhepagiq, *Rrethanat arsimore dhe shkollat*, Mitrovica dhe rrethina, Mitrovicë, 1979, f. 179.

⁴² Izber Hoti, *Prishtina dhe rrethina ndërmjet dy luftërave botërore* (punim magjistrature), Prishtinë, 1978, f. 205.

⁴³ *Po aty*.

⁴⁴ Si shënimi 5, f. 35.

ndërsa në tri bibliotekat e qytetit dhe në atë të shkollave, veçanërisht në Gjimnazin e Shkollës Teologjike, fondet e librave ishin ekskluzivisht në gjuhën serbokroate dhe në gjuhë të huaja.⁴⁵

Në Kosovë në këtë periudhë nuk kishte ndonjë veprimtari botuese në gjuhën shqipe. Librat në gjuhën shqipe ishin të ndaluara. Këto silleshin në mënyrë ilegale nga Shqipëria dhe nga vende të tjera. Po që se ndonjërit i ziheshin në dorë, dënimet ishin të rrepta. Vlen të theksojmë se Prizreni ishte njëri ndër punktet kryesore për shpërndarjen e kësaj literature në Kosovë”.⁴⁶

Nga sa u tha deri më tash mund të konkludojmë se gjatë tërë ekzistimit të Jugosllavisë së Vjetër u bë shumë pak për arsimimin e masave të gjera dhe një gjendje e këthillë mbeti deri në Luftën e Dytë Botërore. Qëndrimi i Mbretërisë së Jugosllavisë borgjeze ndaj çështjes së arsimit të shqiptarëve ishte i prerë. Kjo Mbretëri lejoi për shqiptarët vetëm edukimin fetar dhe veprimtarinë e institucioneve fetare, për të cilat planifikohej se do të shërbenin si instrumente, nëpërmjet të të cilave do të ushtronte më lehtë ndikimin e vet mbi masat e shtypura të popullit. Këtë e dëshmon më së miri fakti se, edhe pse për kombësitë e tjera (gjermane, hungareze, rumune, ruse, italiane etj.) ekzistonte shkolla utraquistike, ku mësimi zhvillohej në gjuhët amtare, për pjesëtarët e kombësisë shqiptare nuk u hapen këso shkollash apo paralelesh.⁴⁷

Prapambeturia në lëmin e kulturës dhe të arsimit pasqyrohej në rrjetin e dobët të shkollave, të shkollës fillore dhe të mesmes, si dhe në institucionet kulturore, në vijimin e dobët të mësimin nga ana e fëmijëve, sidomos nga fëmijët shqiptarë si në shkollat e ulëta, ashtu edhe në të mesmet dhe në mbretërimin e analfabetizmit.

Që të kishin kombet dhe kombësitë trajtim të barabartë në shkollim, rol të rëndësishëm luajti PKJ. Me punën e vet revolucionare ajo nxiti procesin progresiv kulturor-arsimor.

Konferenca e Parë e PKJ-së vuri në pah pozitën e vështirë të shqiptarëve, të cilët nuk kishin „barazi kulturore-nacionale” dhe „kërkon mbrojtjen më të plotë të të drejtave kulturore-nacionale të pakicave kombëtare”.

Në fillim legalisht, ndërsa nga Obznana, në kushtet ilegale, nëpërmjet anëtarëve të vet dhe punëtorëve përparimtarë të arsimit, ajo hapi shtigjet e barabarësisë dhe të ideve të reja në arsimim dhe edukim. Në Kongresin e Bashkimit dhe në Kongresin e Dytë u theksua kërkesa për shkollimin e domosdoshëm të fëmijëve të të dy gjinive me shpenzime të shtetit.⁴⁸

PKJ-ja gjatë veprimtarisë së vet revolucionare në Jugosllavinë borgjeze barabarësinë në lëmin e arsimit e konsideronte pjesë të pandashme të progresit dhe të lirisë së çdo populli. Kështu, në Rezolutën e Konferencës së Tretë të PKJ-së, arrihet edhe më larg

⁴⁵ Si shënimi 21, f. 4.

⁴⁶ *Po ai*, f. 35.

⁴⁷ Si shën. 18, f. 85.

⁴⁸ Mr. Golub Mirković, *Komunistička Partija Jugoslavije i prosvetno-kulturne prilike na Kosovu između dva rata, Kosova* 11, Prishtinë, 1982, f. 24.

sa i përket të drejtave të pakicave kombëtare. Aty theksohet: „PPPJ do të luftojë që pakicave kombëtare, pos barazisë së plotë politike e qytetare, t'u garantohet edhe e drejta e pakufizueshme për përdorimin e gjuhës amtare në komunikim në të gjitha organet e pushtetit, shkollimi i obligueshëm i fëmijëve në gjuhën amtare në të gjitha shkollat shtetërore”.⁴⁹

Gjatë tërë kohës së ekzistimit të Jugosllavisë së Vjetër kuadri mësimor përparimtar i radhëve të të gjitha kombeve dhe kombësive, të prirë nga komunistët, luftuan kundër politikës së regjimit të atëhershëm. Kjo luftë e punëtorëve të arsimit dhe e nxënësve përparimtarë është pjesë përbërëse e atij aktiviteti revolucionar, i cili ka hyrë në historinë e lëvizjes sonë revolucionare.⁵⁰

Punëtorët e arsimit janë ngritur haptazi kundër politikës së padrejtë arsimore, e cila zbatohet, duke kërkuar që ajo të përcaktohet në frymën e kërkesave të popullit dhe të interesave të tij.⁵¹

Edhe më parë, por edhe në atë kohë, një numër i konsiderueshëm i punëtorëve të arsimit, serbë e shqiptarë, i takonin lëvizjes socialiste, më vonë PKJ-së.⁵²

Shkollat u bënë baza të rëndësishme revolucionare të cilat u sillnin gjithnjë e më shumë kokëçarje pushtetmbajtësve. Në Gjinnazin e Pejës, të Prishtinës e të Prizrenit komunistët kishin ndikim të madh. Aty zhvillohet veprimtari revolucionare, sepse aty ishin të rinjtë që i dallonin më së tepërmi padrejtësitë dhe peshën e rëndë të politikës borgjeze. Janë të njohura reprezaljet që i ndërmoi regjimi i atëhershëm kundër profesorëve dhe nxënësve përparimtarë. Në mesin e entuziastëve të asaj kohe ishte edhe punëtori i arsimit Miliq Shçekiq nga Peja.⁵³

Në këtë periudhë formohen nëpër shkolla organizata përparimtare që punonin nën mbikëqyrjen e komunistëve. Qysh në nëntor të vitit 1932 në Gjinnazin e Prishtinës formohet Shoqata letërore „Agimi” (Zora) të cilën e përbënin rinia përparimtare. Po këso shoqatash formohen edhe në gjinnazet e tjera të Krahinës, si ajo „Napredak”, („Përparimi”) (1920).⁵⁴

Duhet theksuar se vendimet e Konferencës së Katërt ishin edhe më konkrete. Këtu shtrohet kërkesa për përdorimin e gjuhëve amtare në shkolla, në gjyqe dhe në ushtri, në viset ku jetonin shqiptarët.⁵⁵

Me ardhjen e Josip Brozit në krye të PKJ-së, u kristalizuan qëndrimet e qarta marksiste të Partisë mbi barazinë kombëtare dhe mbi kultivimin e kulturave kombëtare dhe, në përgjithësi mbi arsimimin në gjuhët amtare.

⁴⁹ *Istoriya XX veka*, Beograd, 1959, 242—244.

⁵⁰ Si shënimi 18, f. 86.

⁵¹ Pavle Jovičević, M. Milković, *Prvi koraci KPJ u Peći*, Jedinstvo, Priština 1979, gusht 16—17, f. 13—10.

⁵² Miodrag Nikolić, *Revolucionarni radnički pokret na Kosovu i Metohiji, 1895—1922*, Priština, 1962, 151.

⁵³ *Po aty*.

⁵⁴ Si shën. 18, 87.

⁵⁵ Si shën. 48, f. 23.

Në artikujt dhe diskutimet e veta Josip Broz Tito në frymën e klasikëve të marksizmit rëndësi të posaçme i kushtonte arsimimit dhe shkollave, duke cekur, para së gjithash, rolin e saj të pazëvendësueshëm në shoqëri. Ai vuri në pah rëndësinë funksionale të shkollave në vendet e prapambetura siç është Kosova, duke cekur se shkollat duhet të jenë të hapura për të gjithë njerëzit.⁵⁶

Lufta e PKJ në realizimin e barabarësisë në arsimim dhe edukim ishte e ndërlikuar dhe zgjati deri në fitoren e Revolucionit Socialist.

Mr. Sulltane Kojçini — Ukaj

L'ENSEIGNEMENT ET LES ÉCOLES EN KOSOVÉ ENTRE LES DEUX GUERRES MONDIALES

R é s u m é

La période du règne bourgeois de l'ancienne Yougoslavie est caractérisée d'une grande arriération culturelle et éducative qui se rend évident dans un petit réseau d'écoles, des écoles primaires et secondaires d'une faible fréquentation de l'enseignement par les enfants. Le réseau des écoles s'étendait à l'esprit de l'idéologie régnante bourgeoise. D'abord, les premières écoles s'ouvrirent dans les villages habités par les Serbes du pays et fort peu dans les locaux où vivaient les Albanais en particulier, et que l'enseignement se faisait en serbocroate.

Ce manque d'enseignement, d'écoles primaires d'Etat, les masses populaires de la croyance islamique, les Albanais et les Turcs le remplissaient par les écoles religieuses pour les enfants, le *Sebien* mecteb, dont elles étaient étrangères pour les enfants. L'enseignement plus ample et plus approfondi se faisait dans les medressés lesquels n'étaient qu'une continuation de l'époque de l'Empire ottoman. Les lycées en Kosové s'ouvrirent en 1913/14 et fonctionnent à Prishtinë, à Pejë et à Prizren, Dans les années scolaires 1919/20, à Gjilan, Ferizaj et à Mitrovica s'ouvrirent des progymnases. Le nombre des Albanais dans ces progymnases était trop petit, on ne reconnaissait pas l'appartenance nationale aux élèves car ils se traitaient comme turcs de Yougoslavie.

Pour les besoins économiques, s'ouvrirent aussi des écoles d'un niveau bas, professionnelles c'est à dire des écoles d'artisanat et d'apprenti qui en effet n'avaient pas l'équivalence de l'école secondaire. Elles furent ouvertes dans quelques centres de la Kosové et continuèrent leur existence jusqu'en 1948, et se fermèrent définitivement.

Pendant toute l'existence de l'ancienne Yougoslavie s'était peu fait à l'enseignement des larges masses, un tel état resta jusqu'à fin de la Deuxième guerre mondiale. Le Parti communiste avec son travail révolutionnaire, engagé pour l'égalité dans le procès éducatif — culturel le considère d'une partie inséparable du progrès et de la liberté de chaque peuple.

⁵⁶ Dr. J. Redžepagić, *Tito o vaspitanju i obrazovanju*, „Tito o Kosovu — Kosovo o Titu”, Prishtinë, 1979, 228.

